



Breaking News: Raporti i ngjarjeve, 13 shtator 2024



Lajmet

13/09/2024

Sarandë – Përshtatën Ambientet E Një Lokali, Për Shitjen E Drogave, Arrestohen 2 Shtetas

DVP Vlorë/Vijon megaoperacioni policor antidrogë i koduar “Tempulli”.

Përshtatën ambientet e një lokali, në Sarandë, për shitjen e dozave të kokainës dhe të kanabisit, arrestohen 2 shtetas (pronari i lokalit dhe kamerieri).

Gjatë kontrollit në këtë lokal u gjet e fshehur 1 armë zjarri pistoletë.

Sekuestrohen pistoletë, doza kokaine dhe kanabisi, një shumë parash, 2 peshore elektronike dhe 2 celularë.

Si rezultat i administrimit të menjëhershëm të informacioneve të siguruar nga inteligjenca policore, në kuadër të megaoperacionit “Tempulli”, për dy shtetas që po shisnin doza të lëndëve narkotike në një lokal në Sarandë, Seksioni për Hetimin e Narkotikëve i DVP Vlorë finalizoi operacionin policor të koduar “Parts 32”.

Gjatë operacionit u arrestuan në flagrancë shtetasit G. H., 34 vjeç, dhe M. Sh., 17 vjeç, të dy banues në Sarandë.

Nga kontrolli në lokalin në pronësi të shtetasit G. H., ku ishte i punësuar kamerier shtetasi M. Sh., shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan në cilësinë e provës materiale: 40 doza të lëndës narkotike kokainë dhe disa doza kanabisi, gati për shitje, 1 armë zjarri pistoletë, 37 500 lekë, 230 euro, 40 franga dhe 70 paund, 2 peshore elektronike dhe 2 celularë.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, për veprime të mëtejshme.

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital

GET IT ON
Google Play

Download on the
App Store

Arkiva

Select Month ▾

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)

◀ Drejtoria Vendore e Policisë Vlorë, gjatë 24 orëve të fundit

Drejtoria Vendore e Policisë Shkodër, gjatë 24 orëve të fundit ▶